



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA

Bul. "Ilinden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 133** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 07.09.2018 deri më 21.09.2018.

Tetovë, më 07.09.2018



REFERAT

PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE ASISTENT NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Me propozim-vendim të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës dhe vendim të Këshillit të Rektoratit numër **02-3006/1** të datës **13.07.2018**, dhe në bazë të konkursit të shpallur më: **04.06.2018** në gazetën ditore “Koha” dhe “Nova Mkedonija” është caktuar komisioni recensues për zgjedhjen e njëb asistenti për lëndët **Fiziologji-I** dhe **Fiziologji-II**, me komisionin në përbërje:

1. **Prof. dr. Lutfi Zylbeari (kryetar)**, profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës,
2. **Prof. dr. Kastriot Haxhirexha (anëtar)**, profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës,
3. **Prof. dr. Fatmir Ferati (anëtar)**, profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti i Tetovës.

Ne konkurs janë paraqitur dy kandidat :

1. **Dr.med. Avdi Nazifi**
2. **Dr. Vjosa Xhaferi**

Komisioni i lartëpërmendur pasi që i pranoi dhe shqyrtoj materialet e dorëzuara në konkurs, titullit të lartëpërmendur i paraqet këtë:

R A P O R T

Me datë **04.06.2018** në gazetat “Koha” dhe “Nova Makedonija” është shpallur konkurs për zgjedhje të një asistenti për lëndët **Fiziologji-I** dhe **Fiziologji-II** në Fakultetin e Shkencave Mjekësore.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar, komisioni në fjalë, paraqet raport recensioni për kandidatin:

1. Ass. Dr. med. Avdi Nazifi, (PhD candidate)

TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ARSIMIMI

Ass. Dr.med. AvdiNazifi, është ilindur më 08.06.1982nëfshatinKalisht, komuna e Gostivarit. Shkollëfilllore e mbaroi në vendlindje, ndërsashkollimin emesëm nëShkollën e Mesme Medicinale “Nikolla Shtejn” Tetovë.

Studioi nëFakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit të Tiranës, ku diplomoi në vitin 2009 dhe mori titullin “**doktor i mjekësisë**”.

Pas mbarimit të studimeve, licenohet si mjek pranë Dhomës së Mjekëve të Republikës së Maqedonisë dhe menjëherëështë punësuar (në vitin 2010) si **mjek i përgjithshëm** në organizatën private shëndetësore “*Albi Medika*” në Tetovë.

Në vitin 2011 ndjek edukimin profesional nga fusha e ultrasonografisë, në Klinikën e Radiologjisë, nëQendrën Klinike Universitare “Nënë Tereza” nëShkup, ku certifikohet dhe licenohet për kryerjen e pavarur të“*echosonografisë së organeve abdominale*”nën udhëheqjen e Prof. Dr. Klime Gjoreski.

Më pas, në shtator të vitit 2012, angazhohet si **asistent** për lëndët **Fiziologji I** dhe **Fiziologji II**, në programet studimore: mjekësi e përgjithshme, stomatologji dhe infermieri, pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës, ku edhe vazhdon të jetë i angazhuar për lëndët përkatëse.

Në janar të vitit 2015, në Tiranë, ndjek edukimin e dytë nga fusha e echosonografisë, me fokus të vecantë“*echosonografinë e gjëndrës tiroide*” nën udhëheqjen e Prof. Dr. Maksim Cela.

Në tetor të vitit 2016, regjistron studimet e ciklit të tretë, **doktoraturës**,nga fusha e **biomjekësisë**, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, pranë Universitetit të Tetovës, ku ështëduke përgaditur punimin e doktoraturës nga fusha efiziologjisë dhe patofiziologjisë së gjëndrës tiroide, nën udhëheqjen e mentores Prof. Dr. Sheqibe Beadinit.

Ass. Dr. med. Avdi Nazifi është njohës i gjuhës italiane, gjermane dhe maqedonase. Ka të kryera kurse për përdorimin e programeve kompjuterike të paketës Microsoft Office.

Komisioni i recensentëve i mori arritjet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike si dhe arritjet e tjera të kandidatit që nga fillimi i karrierës, si dhe arritjet e përgjithshme shkencore, profesionale, pedagogjike si dhe arritjet e tjera të kandidatit mbi bazën e tërë dokumentacionit të paraqitur me rëndësi për zgjedhjen.

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Që nga shtatori i vitit 2012, Dr. med. Avdi Nazifi angazhohet si **asistent** pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës, ku angazhohet dhe mban mësimin praktik për lëndët **Fiziologji I** dhe **Fiziologji II**, në programet studimore: mjekësi e përgjithshme dhe stomatologji, dhe në lëndën e **Fispatologjisë** në programet studimore Stomatologji, Infermieri, Fizioterapi dhe Akushi.

Ass. Dr. med. Avdi Nazifi në mënyrë kontinuale ka mbajtur mësim në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës, në lëndët e sipërpërmendura ku dhe vazhdon të mbajë edhe aktualisht.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Avdi Nazifi ka realizuar gjithsej 73.8 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është marrë me hulumtime shkencore në fushën e shkencave të mjekësisë dhe ka botuar disa punime shkencore në lëminë e mjekësisë në revistat shkencore, në publikimet shkencore ndërkombëtare dhe në përmbledhjet e konferencave shkencore të cilat janë të cituara në shtojcën që pason.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i i universitetit), kandidati Ass. Dr. med. Avdi Nazifi ka realizuar gjithsej 15 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Ass. Dr. med. Avdi Nazifi është **mjek i përgjithshëm** në organizatën private shëndetësore “*Albi Medika*” në Tetovë. Është anëtarë i Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë dhe antarë i Shoqatës së Mjekëve të Maqedonisë.

Kandidati Ass. Dr. med. Avdi Nazifi ka marrë pjesë në shumë kongrese vendore dhe kongrese ndërkombëtare në lëminë e mjekësisë, ka qenë ligjërues në temat mjekësore për avansimin dhe trajnimin e mjekëve të rinj në kongrese dhe seminare mjekësore të prezentuara në lëminë e mjekësisë.

Dhe, në përputhje me Rregulloren dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Ass. Dr. med. Avdi Nazifi ka realizuar 2 pikë në këtë veprimtari.

VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJËRË

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidati Ass. Dr. med. Avdi Nazifi në këtë veprimtari ka grumbulluar 2 pikë.

LISTA E PUNIMEVE SHKENCORE TE PUBLIKUARA ME RECENSION NDERKOMBETAR

Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord ndërkombëtar

Sh. Beadini, N. Beadini, A. Nazifi, N. Durmishi, A. Beadini

“The impact of testosterone, spermatogram and sperm culture in the appearance of male infertility in Western Macedonia”

UNIVERSI-International Journal of Education, Science, Technology, Innovation, Health and Environment, Volume 01-Issue 01, December 2014 ISSN: 1857 – 94504

Beadini N, Bajrami Z, BeadiniSh, Bexheti S, Zylbeari L, Beadini A, Nazifi A

“Defining patient risk for transaminitis during statin therapy”

UNIVERSI-International Journal of Education, Science, Technology, Innovation, Health and Environment, Volume 1, Issue 3, August 2015

ISSN: 1345 – 9893

Beadini N, Bara P, BeadiniSh, Bexheti S, Nazifi A, Beadini A

“Microbiological analysis and antibiogram profile in pharyngitis cases and its treatment with antibiotic”

UNIVERSI-International Journal of Education, Science, Technology, Innovation, Health and Environment, Volume 1, Issue 3, August 2015

ISSN: 1345 – 9893

Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në përmbledhje punimesh nga tubim shkencor me bord ndërkombëtar

Besmira Zama, Tritan Kalo, Avdi Nazifi, Stela Muca

“A very case of nosocomial fatal necrotizing fasciitis due to pseudomonas Aeruginosa in an immunocompetent subject”

“The 1st Scardus Conference” - International Association for Education, Science, Technology, Innovation, Health and Environment. & Association for Anglo-American Studies, August 2015

ISSN: 1857-9450

Avdi Nazifi, Besmira Zama,

“Hepatiti B, rëndësia klinike dhe preventiva”

“The 1st Scardus Conference” - International Association for Education, Science, Technology, Innovation, Health and Environment. & Association for Anglo-American Studies, August 2015
ISSN:1857-9450

Pjesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat - prezentim oral

Avdi Nazifi¹, Nexhbedin Beadini¹, Mynyr Koni², Sheqibe Beadini¹, Irfan Ahmeti³
“Përcaktimi i nivelit të statusit hormonal të tiroidës dhe Anti – TPO – së tek grupmoshat dhe gjinitë e ndryshme të jetës”
Fisrt International Scientific Conference of Faculty of Medical Science – ISCFMS, June, 2016

2. Dr. Vjosa Xhaferi

Adresa : Boro Voliq 28, 1200 Tetovë

Asistente në lëndën e Fiziologjisë Idhe II

Gjinia : Femërore

Data e Lindjes : 07.11.1991

1 Shtator 2016 – Asistent , Fakulteti I Shkencave Mjekësi e Përgjithshme (Republika e Maqedonisë). E pranuar në vitinshkollor 2016/17.

Organizuese e ushtrimeve në lëndën e “ Biologji Humane” për studimet e Fizioterapisë.

1 Shtator 2016 Professore në Shkollën e Mesmetë Mjekësisë “ Nikolla Shtejn” , Tetovë) Republika e Maqedonisë

Profesor në Shkollën e Mesme në lëndën e “Fiziologjisë, Pediatri, Biokimi Klinike”

26 Maj 2016 -31 Gusht 2016 Mjete e Përgjithshme Kujdesi parësor privat “Dr, Bekim I Tetovë (Republika e Maqedonisë)

Shtator 2014: Aktiviste e Shëndetit Publik (Qelizat Blu BCI) Shkup , Republika e Maqedonisë

15.09.2010 -26.05.2016 Doktor Mjekësisë

Fakulteti I Shkencave Mjekësore , Mjekësi e Përgjithshme , Universiteti Shtetëror I Tetovës (Republika e Maqedonisë)

Studimet e Mjekësisë së Përgjithshme

Studimet Paraklinike (Biologji , Gjenetikë , Histologji , Biofizikë , Fiziologji , FizPatologji, Biokimi , Immunologji)

Studimet Klinike: (Mjekësi Interne, Kirurgji, Gjinekologji , Pediatri , Neurologji)

Nderi I parë ju dhanë 2010-2016 gjeneratës së Fakultetit të Mjekësisë nga Rektori I Universitetit të Tetovës.

Maj 2016- Dhjetor 2016 U liçensua si Mjek I Përgjithshëm

Tetor 2015 , Becici , Mal i Zi

EFIS-EJI Shkolla Europiane e Imunologjisë (SEEIS20125) 16-19 Tetor Becici , Mal
iZi

1 Qershor -17 Qershor 2011 Trajnimet e Programeve Edirne , Turqi

Gjuha amë – Gjuha Shqipe

Gjuhët e Huaja :Gjuha Maqedonase – Niveli C2

Gjuhë Angleze – Niveli B2

Gjuhë Turke Niveli C1

Gjuhë Gjermane – Niveli B1

Aftësi Komunikimi– Posedon komunikim te shkëlqyeshem verbal, Është me
experience përpara audiencës .

Publikimet :Vjosa Xhafer dhe Ramadani P “ Shoqërimi i pH në Spermë dhe infertiliteti
tek meshkujt”

Konferenca e parëshkencore e fakultetit të Mjekësisë dhe Zhvillimit Dinamik të
Mjekësisë Moderne 3-4 Korrik 2016. Fakulteti I Shkencave Mjekësore ,Tetovë , Republika
e Maqedonisë.

Alili A, Xhaferi V ,Ramadani P “ Ndryshimet Endokrine dhe Morfologjike tek
pacientët me ovarë policistike” – Konferenca e Parë Shkencore në fakultetin e Mjekësisë ,
Tetovë , Maqedoni.

13-14 Tetor Xhaferi V ,Denjalli I “ Prevalenca dhe Incidenca e Lekemisë Limfoblastike
Akute dhe Leukemia Mieloide Akute në Republikën e Maqedonisë , Fakulteti I Shkencave
Mjekësi e Përgjithshme , Tetovë , Maqedoni

16-19 Tetorë EFFIS (Shkolla Evropiane e Imunologjisë) Becici , Mal iZi : Denjalli I ,
Xhaferi V , Pranvera R “ Ekspresioni I Gjenevenë Leukeminë Limfoblastike Akute dhe
leukemia mieloidekronike , prevalence dhe Incidenca e Leukemisë në popullatën e
Republikës së Maqedonisë .

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm dhe biografinë e kandidatit Ass. Dr. med. Avdi Nazifi, Komisioni Recensues konstaton dhe vlerëson se: Ass. Dr. med. Avdi Nazifi posedon cilësi të larta shkencore-profesionale dhe në bazë të Ligjit për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë, në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ai i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhë në thirrjen për të cilën ka konkuruar.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë e veçant që Këshillit të Rektoratit pranë Universitetit të Tetovës t'i propozojë, që kandidati Ass. Dr. med. Avdi Nazifi, të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore ASISTENT PËR LËNDËT: FIZIOLOGJI I DHE FIZIOLOGJI II.

Tetovë, Qershor 2018

Komisioni recensues:

Prof. dr. Lutfi Zylbeari (kryetar)

Prof. dr. Kastriot Haxhirexha (anëtar)

Prof. dr. Fatmir Ferati (anëtar)
